



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
DURRËS**

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 16, datë 14.06.2021

(Për hetimin, ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës mbi bazë gjinore, ndaj të miturve dhe dhunës në familje)

Në mbështetje të neneve 43 dhe 46 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqiperisë”, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëni familjare” i ndryshuar, ligjit nr. 7895 datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.17 dt.13.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje” të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës” të miratuar me Urdhërin nr. 2 datë 15.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës;

UDHËZOJ

Parimet

1. Veprimtaria e policisë gjyqësore dhe vendimarrja e prokurorit, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje, duhet të udhëhiqet nga parimet e:

- a) barazisë dhe mosdiskriminimit;

- c) respektimit të dinjitetit;
- ç) procedimit pa vonesa;
- d) mbrojtjes nga rivictimizimi dhe sigurisë së viktimës; dh) dënimit që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shkelura nga vepra penale si dhe parandalimin;

Format e dhunës

1. Dhuna kundër grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave nëpërmjet akteve të dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje të paligjshme të lirisë, si në jetën publike ose atë private.
2. Dhuna gjinore kundër grave, përfshi dhe vajzat nën moshën 18 vjeç, nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale.
3. Format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të parashikuara në Kodin Penal, dhe sipas kuptimit/interpretimit të Konventës së KiE-së "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"¹ janë:
 - i) Dhuna fizike i referohet dëmtimit trupor që viktima vuan si pasojë e një ushtrimi të forcës trupore të menjëhershme dhe të paligjshme, përfshi dhunën që shkakton vdekje të viktimës;
 - ii) ii) Dhuna Psikologjike i referohet çdo sjelljeje të qëllimshme që dëmton rëndë integritetin psikologjik të viktimës nga një person tjetër përmes shtrëngimit ose kërcënimit;
 - iii) iii) Përndjekja është çdo formë e kontrollit apo mbikëqyrjes së drejtëpërdrejtë apo indirekte të viktimës, me ose pa kontakt fizik. Zakonisht, ajo ndodh pas përfundimit të marrëdhënieς, por ajo mund të shfaqet edhe gjatë periudhës së marrëdhënieς. Ajo mund, mes të tjerash, të përfshijë kërcënimet dhe ngacmimet, në internet apo jashtë internetit, duke e ndjekur personin, spiunuar, apo duke i shkaktuar viktimës frikë për sigurinë e saj ose të afërmve a personave të lidhur me të;
 - iv) iv) Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin, mbulon të gjitha format e akteve seksuale të kryera mbi viktimën nga një person tjetër pa pëlqimin e dhënë lirisht prej saj dhe të kryera qëllimi sht ndaj saj. Gjithashtu, dhuna seksuale përfshin/mbulon akte të padëshirueshme të natyrës seksuale dhe midis bashkëshortëve;

¹ Shih, Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" e ratifikuar me ligjin nr. 104/2012.

- v) Martesa e detyruar i referohet dhunës/forcës fizike ose psikologjike e ushtruar mbi viktimen për lidhje të pavullnetshme në martesë, ku përfshihet edhe joshja e një personi/viktimen për të shkuar jashtë shtetit me qëllim detyrimin e tij/saj për të lidhur martesë;
- vi) Ndërprerja e shtatzënësisë i referohet ndërprerjes së një shtatzënësie, pa pëlqimin paraprak të gruas/viktimen e cila është informuar dhe ka kuptuar procedurën që do të ndiqet dhe pasojat e saj;
- vii) Ngacmimi seksual i referohet sjelljes verbale, jo-verbale ose fizike me natyrë seksuale dhe pa dëshirën e viktimen, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të saj;
- viii) Sterilizimi dhe gjyntimi i organeve gjenitale (përsa nuk parashikohen si vepër penale më vete) konsiderohen vepra penale ndaj shëndetit, të kryera me dashje me pasoja dëmtim të pérhershëm ndaj shëndetit të viktimen, në rrethanën rëndruese "
- j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë..."

1. Gjatë marrjes së të dhënave/intervistimit nga **gruaja viktimen e dhunës ose viktima e dhunës në familje, duhet të mbahet në konsideratë sa vijon:**

- a) **intervistimi të bëhet nga prokuror ose oficer i policisë gjyqësore femër;**
- b) intervistimi të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur;
- c) viktimen t'i jepet mundësia të asistohet nga një person i besuar, koordinatori i viktimateve ose psikologu, sipas rastit;
- d) nëse viktima ka fëmijë të mitur, të njoftohet njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe të shmanget prania e tij gjatë intervistimit të nënës/prindit;
- e) viktima gjatë intervistimit të ndihet e sigurt dhe t'i jepet mundësia të tregojë ngjarjen dhe ndikimin që pati tek ajo;
- f) viktima të pyetet nëse ka një histori dhune/abuzimi dhe/ose urdhër mbrojtjeje;
- g) gjatë intervistimit të komunikohet me gjuhë të kuptueshme për viktimen duke shmangur termat teknikë dhe pyetjet indirekte;
- h) viktima të përgatitet dhe të pyetet nëse është e gatshme të përgjigjet për pyetje intime dhe t'i shpjegohet pse kjo është e nevojshme;
- i) gjatë intervistimit viktima të mos orientohet drejt pajtimit me dhunuesin;
- j) gjatë intervistimit të dokumentohet gjendja fizike dhe emocionale e viktimen;
- k) kur viktima shfaq shenja të humbjes së kujtesës, mungesës së përqëndrimit, përgjigje shumë emocionale (tregues të traumës), të tregohet kujdes për të vendosur një komunikim që nuk shkakton riviktimizim dhe të ndihmohet të tejkalojë eksperiencën traumatike, duke vlerësuar kryerjen e një ekspertimi psikologjik.

2.Në rastet e kallëzimeve penale apo ngjarjeve kriminale që kanë të bëjnë me vepra penale të dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve apo që kanë të bëjnë me dhunën në familje oficerët e policisë gjyqësore duhet që:

- Të njoftojnë menjëherë prokurorin e gatshëm për njoftimet për veprat penale të dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve apo që kanë të bëjnë me dhunën në familje pas fillimit të kryerjes së veprimeve të para hetimore të njoftojnë menjëherë prokurorët e gatshëm të seksioneve përkatëse duke i vënë në dijeni për secilin rast, komunikim i cili duhet të vazhdojë deri në momentin e arrestimeve në flagrancë apo ndalimeve me iniciativë të mundshme, apo dhe referimin e rastit në prokurori.
- Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë viktimën për të drejtat e parashikuara në ligj dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr.5/2018, për të garantuar realizimin e tyre, si dhe personalisht ose nëpërmjet koordinatorit, t'i japin informacion viktimës lidhur me hapat që do të ndiqen për çështjen.

3.Oficerët e policisë gjyqësore, në rastet e veprave penale të kryera ndaj viktimate të dhunës me bazë gjinore, të mitur apo viktimate të dhunës në familje, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme të parashikuara në ligj për mbrojtjen viktimate si dhe duhet të përdorin diskrecionin dhe gjykimin e tyre të kujdeshëm gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj viktimës dhe mundësive që ekzistojnë për mbrojtjen e saj. Ata duhet të marrin në konsideratë problemet e sigurisë së viktimës gjatë gjithë procedimit penal dhe duhet të konsultohen e të koordinojnë me Policinë e Shtetit, Shërbimin e Provës, autoritetin e burgjeve dhe agjenci të tjera që kanë polici gjyqësore, me qëllimin për të plotësuar nevojat për siguri të viktimës. Nga ana tjetër, Policia e Shtetit, punonjësi i policisë gjyqësore duhet të referojnë tek prokurori i çështjes çdo shqetësim lidhur me sigurinë e viktimës, si dhe çdo kallëzim apo provë për kërcënimë të mundshme ndaj saj. Viktima duhet të informohet për mënyrat që mund të jenë të disponueshme për të garantuar sigurinë e saj. Përgjegjësia për të siguruar mbrojtje fizike të arsyeshme dhe të përshtatshme për viktimen, sipas vlerësimit të bërë në bashkëpunim me prokurorin, i ngelet Policisë së Shtetit gjatë gjithë procesit penal.

4. Oficerët e policisë gjyqësore, në veprimet e para hetimore, për të siguruar mbrojtjen e interesave të viktimate, si dhe për të parandaluar kryerjen e veprave të njëjtë apo më të rënda penale, të vlerësojnë rast pas rasti mundësinë e zbatimit me efikasitet të masave të arrestit në flagrancë apo ndalimit me iniciativë të autorëve të dyshuar të veprës penale, sipas kritereve të K.Pr.Penale, duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprës apo autorit të saj, si dhe menjëherë të njoftojnë prokurorin e gatshëm të seksionit përkatës të prokurorisë.

5.Në rastet e kallëzimeve penale apo ngjarjeve kriminale që kanë të bëjnë me vepra penale të dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve apo që kanë të bëjnë me dhunën në familje prokurori i gatshëm duhet që:

- Në rastet e gadishmërisë të jenë të disponueshëm për të komunikuar me oficerët e policisë gjyqësore që marrin kallëzimet penale apo dokumentojnë ngjarjen gjatë veprimeve të para hetimore, duke i orientuar ata në kryerjen e veprimeve të para hetimore dhe mbledhjen e provave.
- Ndjekja penale duhet të jetë e shpejtë për tëshmangur kërcënimet e presionin ndaj viktimës dhe vështirësitë që mund t'i shkaktohen asaj nga vonesa. Në rastet kur nuk procedohet me arrestimin apo ndalimin e të dyshuarve, referimi I materialit hetimor në Prokurori të bëhet brenda 24 orëve. Në ditët e pushimit zyrtar të njoftohet prokurori I gatshëm I cili vlerëson nëse duhet të regjistrohet menjëherë materiali hetimor dhe të kryhen veprime urgjente.
- Prokurorët, në bashkëpunim me oficerët e policisë gjyqësore dhe personelin e prokurorisë kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës, si pjesë e të drejtës së saj kushtetuese për jetë, duke përdorur diskrecionin dhe gjykimin e tyre të kujdeshëm gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj viktimës dhe mundësive që ekzistojnë për mbrojtjen e saj. Ata duhet të marrin në konsideratë problemet e sigurisë së viktimës gjatë gjithë procedimit penal dhe duhet të konsultohen e të koordinojnë me Policinë e Shtetit, Shërbimin e Provës, autoritetin e burgjeve dhe agjenci të tjera që kanë polici gjyqësore, me qëllimin për të plotësuar nevojat për siguri të viktimës. Viktima duhet të informohet për mënyrat që mund të jenë të disponueshme për të garantuar sigurinë e saj.
- Hetimi duhet të jetë i plotë për të kërkuar, mbledhur, rishikuar dhe vlerësuar të gjithë provat e nevojshme si: foto, akte ekspertimi, histori mjekësore, telefonata në urgjencë, polici, etj., ndalime, arreste apo dënlime të mëparshme, armë, deklarime të personave të njojur, mësues, kolegë, fqinjë, familjarë, vlerësimi i riskut nga policia etj., urdhra mbrojtje, dosjen civile, etj.
- Në fazën e dërgimit të kërkësës për gjykimin e çështjes, prokurori duhet të sigurohet për nivelin e riskut ku gjendet viktima, nëse është rasti për të vlerësuar dhe ngriturakuza të tjera ndaj të pandehurit, për të vlerësuar mundësinë e dëgjimit të viktimës nëpërmjet mjeteve audiovizuale, dhe/ose kërkuar e rekomanduar giyatës masat e nevojshme mbrojtëse të saj.
- Gjatë gjykit të prokurorit duhet të jetë i përgatitur të kundërshtojë provat për karakterin e viktimës që nuk lidhen me ngjarjen, dhe për të menaxhuar sjelljen e viktimës si dëshmitar në gjyq, në mënyrë që të shmangen përpjekjet, në kundërshtim me rrethanat e vërteta të faktit të provuara, e palëve të interesuara në proces, që viktima të konsiderohet jobindëse apo e pavërtetë.
- Prokurori duhet të administrojë prova të mjaftueshme dhe bindëse përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për fajësinë e të pandehurit dhe/ose përgatisë çështjen në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të gjykohet edhe pa dëshminë e viktimës.

6. Prokurori duhet të marrë vetë ose udhëzon Policinë e Shtetit për marrjen e masave të arsyeshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur viktimin nga i pandehuri, nga persona që veprojnë në bashkëpunim me të apo në emër të tij. Masa të tilla mund të jenë, ndër të tjera:

- a) shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;
- b) bërja e kërkesës për nxjerrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje, urdhri mbrojtjeje ose urdhri kufizimi në gjykatë;
- c) bërjen e kërkesës për vendosjen ndaj të akuzuarit të një mase sigurimi i zoluese apo të një mase sigurimi me kushtin e ndalimit të kontaktit me viktimin;
- ç) bërjen e kërkesës për dhënien e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur;
- d) rekomandimin për pranimin e viktimës që është edhe dëshmitar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- dh) marrjen e masave për mbrojtjen fizike të viktimës.

7. Në kërkesat e tyre për dhënien e dënimit për të pandehurit e akuzuar për veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo me dhunën në familje, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të viktimës, prokurorët duhet të vlerësojnë ashpërsimin e masave të dënimit duke pasur parasysh rrezikshmërinë e veprës, përhapjen saj, autorit, mundësinë e përsëritjes së veprës penale apo kryerjes prej autorit të një vepre penale më të rëndë.

8. Në rastet kur nga oficerët e policisë gjyqësore referohen materiale hetimore për vepra penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo për dhunën në familje, në të cilat personi i dyshuar është në gjendje të lirë, prokurori cështjes duke vlerësuar maksimalisht rrethanat e cështjes, rrezikshmërinë e të dyshuarit dhe intesitetin e konfliktit mes viktimës dhe të dyshuarit, duhet të vlerësojë maksimalisht, rast pas rasti, ushtrimin e kompetencave procedurale për ndalimin e të dyshuarit ose t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për caktimin e masës shtrënguese ndaj të hetuarit, me qëllim që vecanërisht të evitohet kryerja e një krimi tjetër nga ky person.

9. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të sektionit dhe shërbimeve të zbatojnë me rigorozitet detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi rolin e koordinatorit për subjektet me status të posacëm.

10. Ngarkohet Drejtuesi i Seksionit për drejtësinë penale për të mitur, ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë për të ndjekur zbatimin e përcaktiveve të këtij udhëzimi dhe detyrimeve të tjera ligjore dhe nënligjore nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të sektionit dhe shërbimeve. Në cdo rast ky Drejtues Seksioni informon me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë për problematikat e hasura.

11. Drejtuesit e Seksioneve përkatësë sipas ndarjes së veprave penale objekt i këtij udhëzimi, në zbatim të Udhëzimit nr.12, dt.20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të kërkojë informacione për cështje konkrete nga prokurorët dhe të nxjerrë konform ligjit, udhëzime jo të detyrueshme për cështje konkrete për cështjet penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo për dhunën në familje.

12. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës dhe pranë shërbimeve në Drejtorenë Vendore të Policisë Durrës dhe Komisariatin e Policisë Durrës, Shijak si dhe pranë të gjitha shërbimeve të policisë gjyqësore në institucione të tjera. Një kopje e këtij udhëzimi tju komunikohet me anë të emailit zyrtar @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.

13. Ky udhëzim hyn ne fuqi sot në datë 14.06.2021.

DREJTUESI I PROKURORISË

ANITA JELLA

